



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 15.10.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË
BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, SHQIPËRI - KOSOVË 2014-2020,
ALOKIMET PËR VITIN 2016”**

Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 15.10.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II)” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

1. Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin, Z. Gazmend Barbullushi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Znj. Daniela Cekani, Drejtore e Fondeve IPA në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë, ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të zonave si dhe të forcojë më tej bashkëpunimin natyral ndërmjet dy shteteve. Programi ka reflektuar rëndësinë që BE-ja i kushton çështjeve horizontale dhe ndërsektoriale, çështje këto të reflektuara përmes përzgjedhjes së prioritetëve të tilla si krijimi i partneriteteve ndërkufitare, “autorësia” vendore dhe mundësitë e barabarta, garantimi i mosdiskriminimit të minoriteteve, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore etj. Ky ratifikim mundëson zbatimin e projekteve specifike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, të cilat përveç shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencave, do të sjellin rezultate të dukshme në sektorin e mjedisit, turizmit, punësimit etj.

Marrëveshja financiare u nënshkrua për palën Shqiptare, në korrik 2017. Programi i veprimit e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Shqipëri - Kosovë 2014-2020, u miratua nga Komisioni Europian me vendimin zbatues në dhjetor 2014. Alokimet e vitit 2016, për këtë program, financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA) me një buxhet total, për të dyja vendet, prej 1 411 765 euro dhe kontributi i Unionit në 1 200 000 euro. Periudha e ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje financiare është 12 vjet nga hyrja në fuqi e saj.

Në total, kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Shqipëri-Kosovë, për periudhën 2014-2020, arrin vlerën 8 400 000 euro. Alokimet e mëtejshme do të jenë objekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Në mënyrë më të detajuar, programi do të fokusohet në këto prioritetë:

1. Mbrojtjen e mjedisit, përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e riskut;
2. Turizmi dhe trashëgimia natyrore e kulturore;
3. Rinia dhe arsimi, me fokus nxitjen e punësimit.

Marrëveshja e financimit për këtë program përbëhet nga 5 pjesë:

- Shtojca I: Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë për vitet 2015-2017, përmes të cilës bëhet përshkrim i modaliteteve të zbatimit, përfshirë alokimet për çdo vit financiar, prioritetet, kushtet e thirrjeve për projekt propozime dhe monitorimin e performancës së programit;
- Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014-2020 ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, e cila trajton karakteristikat e territorit, prioritetet dhe një pasqyrë të sfidave të mundshme të zhvillimit që mund të trajtohen nëpërmjet projekteve të përbashkëta.
- Shtojca II: Kushtet e përgjithshme, ku parashikohen përgjegjësitë dhe strukturat zbatuese të programit. Ky program do të zbatohet me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian, nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë;
- Shtojca III dhe Shtojca IIIA: Modelet e raportit vjetor të zbatimit për secilin program të bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë dhe një raport të përbashkët për të gjitha programet e bashkëpunimit ndërkufitar që përfiton vendi ynë.

Efektet financiare

Në këtë fazë, është e vështirë të jepet një vlerësim real i të ardhurave dhe shpenzimeve pasi ndarja e buxhetit prej 1 380 000 eurosh për secilin shtet përfitues për alokimin e vitit 2016, mund të bëhet vetëm pas kontraktimit të projekteve fituese. Përfitues të këtij programi nuk do të jenë vetëm institucionet shtetërore buxhetore por edhe organizata e shoqata të tjera jofitimprurëse, të cilat nuk ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore.

Diskutimet në Komision :

Pas prezantimit të projektligjit, deputetët z. Bashkim Fino, znj. Eglantina Gjermani dhe kryetarja e komisionit znj. Mimi Kodheli, ngritën pyetje rreth kontributit të dhënë nga palët e interesuara në program dhe mënyrat e përdorura për konsultimin e këtyre palëve. Një pjesë e rëndësishme e diskutimit u fokusua në efektet financiare të miratimit të projektligjit, si dhe në kërkesën për një informacion më të plotë dhe të detajuar mbi alokimet e miratuara. Pas sqarimeve të nevojshme nga pala e ftuar, komisioni votoi në parim, nën për nën dhe në tërësi projektligjin.

Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimin (IPA II)” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.’”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI